

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitim vepra ujore (kanal+ura)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi dhe grafiku per proceduren jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerivepër këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.532.652 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy)lekë pa tvsh

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ”Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre” i ndryshuar , në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. *Formularin e ofertës sipas shtojcës 1*
- b. *Listen e çmimeve sipas zërave të preventivit bashkëngjitur sipas shtojcës 2*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*
- ç. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- d. *Grafikun e punimeve sipas shtojcës 6*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Deklarata për mjetet dhe punonjësit është e nevojshme për arsye se punimet duhet të realizohen në cilësi dhe afatit të kërkuar sipas dës.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2020,2021,2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2023 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6,

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontratës

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt*

të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:
Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1- A (Punime gërmimi në tokë)
2. NP 5- A (Punime nentokesore ,ura e vepra arti)
3. NP 7- A (Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje)
4. NS 1- A (Punime per prishjen e ndertimeve)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje licencat profesionale sipas zerave te preventivit qe ne baze te marreveshjes se bashkepunimit merr persiper te realizoje).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të liçencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë liçencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen në kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

NP 1	<i>Punime gjermimi në tokë</i>	Punime gjermimi	A	
NP 5	<i>Punime nentokesore ,ura e vepra arti</i>	Riparim ura dhe kanale	A	
NP 7	<i>Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje</i>	Riparim ura dhe kanale	A	
NS 1	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	Punime prishje kollona	A	

N.P-1A (Punime gjermimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gjermime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-5A (Punime nentokesore ,ura e vepra arti)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me rehabilitim ne vepra ujore kanale dhe ura , është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me kete kategori license.

NP 7- A (Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me rehabilitim ne vepra ujore kanale dhe ura ,kanale vaditese , është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me kete kategori license.

NS 1- A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime per prishjen e ndertimeve,, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate ne formularin permbledhes te veteklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- Inxhinier Ndertimi

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë
3. Çertifikate trajnimi për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”,e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

- Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e

shoqërisë dhe te jete I pajisur me Çertifikate trajnimi për”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”,e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”* në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar,pasi për çdo objekt zbatimi duhet të këtë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj si dhe vendimin Nr.312, datë.5.5.2010,“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”

Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt

2.3.4 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO te vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 ”Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit

të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojnë ne formularin e vetdeklarimit se ka te punësuar, minimalisht 9 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator (3)**
- **karpentiere (2)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Manovrator (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin(i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontrates.

- **Punetore te thjeshte (3)**

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë e punetoreve është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

- **Murator (3)**

Bazuar ne zerat e punimeve ne preventive dhe grafikun e punimeve ,per ndertim mur guri ,punime betony ,kanal i hapur betony AK ka kerkuar 3 muratore per realizimin e punimeve

- **karpentiere (2)**

Bazuar ne zerat e punimeve ne preventive dhe grafikun e punimeve ,per ndertim struktura betoni ka kerkuar 2 karpentiere per realizimin e punimeve

- **Manovrator (1)**

Bazuar ne zerat e punimeve ne preventive germim dheu me eskavator AK ka kerkuar 1manovrator per drejtimin e eskavatorit per realizimin e punimeve

- **Punetore te thjeshte (3)**

Bazuar ne zerat e punimeve ne preventiv per punime te ndryshme AK ka kerkuar 3 punetore te thjeshte ndihmes per realizimin e punimeve

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej **minimalisht 10 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.6 .Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 10 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” . Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 10 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Nr	Nr An	Pershkrimi I Punimeve	Njesa	Sasi	OP /NJ	OP/GJITH
		RIPARIM URA FSHATI ORMAN 5X4.6 ml				
1	2.426/7	Prishje kollona ,trare b/a	m3	4	35.2	141
2	An	Hegje panele ure (100x460)cm	cope	5	2	10
3	An	Vendosje panele ure (100x460)cm	cope	5	2	10
4	2,25	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne toke	m3	75	0.067	5
5	3.323	Ndertim mur guri mbajtes M50	m3	10	9.3	93
6	3.352	Mbushje me gure kave	m3	10	3.4	34
7	3.212	Shtresë çakëlli t=15 cm,përhapur e ngjeshur me makineri	m2	50	0.28	14
8	3.244	Beton per trare +bordura C 20/25	m3	4.5	12.8	58
9	3.287	Hekur betoni I zakonshem Φ6-10 mm2	ton	0.24	61	15
10	3.288	Hekur betoni I zakonshem Φ> 10mm2	ton	0.4	42	17
		SHUMA(per 1 ure)				396
		SHUMA(per 4 ura)				1,583
		KANAL I HAPUR BETONI FSHATI ORMAN NR1				

1	2.1	Germim dheu me krah seksjon I detyruar toke e zakonshme	m3	75	3.7	278
2	2.26/a	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne mjet	m3	75	0.067	5
3	3.158/1 a	Transport dheu, mbet nderti ne dist 1km	m3	150	0.1	15
4	An-8	Mbushje me cakell pas mureve	m3	120	0.04	5
5	3,183/a	Shtrese me zhavor 10 cm	m2	555	0.13	72
6	3.243	Struktura monolite betoni C16/20 t= 12cm	m3	80	12.8	1,024
7	3.363	Tombino me tubo betoni Φ 400 mbi shtrese betoni	ml	13	2.5	33
		SHUMA				1,431
		KANAL I HAPUR BETONI FSHATI ORMAN NR 2				
1	2.26/a	Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3,kanal me gjeresi deri 2m,tok e zakonshme,kat.III,shkarkim ne mjet	m3	30	0.067	2
2	3.158/1 a	Transport dheu, mbet nderti ne distanc 1km	m3	30	0.1	3
3	3,183/a	Shtrese me zhavor 10 cm	m2	50	0.13	7
4	3.243	Struktura monolite betoni C16/20 t= 15cm	m3	12	8.6	103
5	An -57	F.V .Tob metalik D=220 mm	ml	13	0.5	7
		SHUMA				121
		TOTALI				3,136

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 3136.
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $3136 : 8 = 392$
kemi 392 punëtorë për një ditë pune
- 392 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 18 punëtorë për një muaj punë.
- 10 punetore shpërndarë sipas grafikut, për 2 muaj.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

Mjetet	Sasia	Gjendja
1. Kamion vetshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 5 deri ne 20 ton	1cope	Pronësi ose me qera
2. Motobetoniere	2cope	Pronësi ose me qera
3. Kamioncine me mase maksimale te	1cope	Pronësi ose me qera

autorizuar sipas lejes se qarkullimit 3.5 ton		
4. Eskavator	<i>Icope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
5. Autovinc	<i>Icope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
6. Autobot uji	<i>Icope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme*
- 5. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia*

dhe për mjetet me qera,

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]*
- 6. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

per mjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

1. Kamion vetshkarkues

Bazuar në zërat e preventivit punime shtresash në rrugë, kërkohen 3 kamion vetshkarkues për transportin e materisleve .

2. Motobetoniere

Bazuar ne zerat e punimeve per punime betoni jane kerkuar 2 motobetoniere per realizimin e tyre

3. Kamioncine

Është kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve

4. Eskavator

Eshte kerkuar nje eskavator bazuar ne zerat e preventivit per germim dheu me eskavator

5. Autovinc

Eshte kerkuar nje autovinc per ngritjen e tombinove sipas zerave te preventivit.

6. Autobot uji

Eshte kerkuar nje autobot uji per punimet e betonit sipas preventivit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).